

Konferenca e Dytë Vjetore e Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit

“Evolucionet në Drejtësinë Kushtetuese Bashkëkohore: Shembulli i Rajonit të Ballkanit”

Prishtinë, Kosovë - 24 Tetor 2024

Holta Zaçaj LL.M.

Presidente e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane /
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

E nderuar Presidente e Republikës së Kosovës,

Të nderuar Kryetarë,

Të nderuar kolegë, pjesëmarrës dhe të ftuar,

Është një privilegj për mua që në cilësinë e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht të Presidentes së Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, të jem sot në Kosovë, vendin që zgjodhëm unanimisht, si vendin pritës të Forumit tonë në mbledhjen e dytë.

Zhvillimi i këtij takimi në shtetin më të ri të rajonit dhe kontinentit rrezaton një simbolikë të rëndësishme: Kjo Republikë e re, megjithë vështirësitë e natyrshme dhe të kuptueshme, ka oportunitetin të ndërtojë jo vetëm një sistem demokratik, por mbi të gjitha një demokraci kushtetuese.

Duke u mbledhur këtu në zemër të Ballkanit, një rajon i pasur me histori, kulturë dhe vlera, i vendosur në orientimin e tij drejt perspektivës evropiane, do doja të sillja në vëmendje rolin e pazëvendësueshëm të gjykatave kushtetuese në mbrojtjen e demokracisë, të drejtave themelore të njeriut, në sundimin e ligjit në një shoqëri të shtetit të së drejtës.

Ballkani është në zemër të Evropës dhe ne ndajmë përgjegjësinë për të kontribuar për një Evropë paqësore, më të bashkuar, më të fortë, më kohezive dhe më të drejtë.

Parimi “Demokraci nën ligj” presupozon në rradhë të parë demokraci nën Kushtetutë. Prandaj, kushtetueshmëria dhe siguria e zbatimi i ligjit është jetike dhe substanciale për sistemin, institucionet dhe vlerat demokratike në vendet tona.

Kjo konferencë, ky takim vjetor i yni, konfirmon përkushtimin e përbashkët ndaj parimeve e vlerave themelore demokratike, të domosdoshme për ruajtjen e kohezionit social, paqes dhe drejtësisë në shoqëritë tona.

Siç e dimë, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë u zgjodh në maj të vitit 2024 për të kryesuar Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Evropiane përgjatë një mandati tre-vjeçar.

Misioni i Konferencës është i lidhur me vizionin, frymën dhe qëllimin e këtij Forumi Ballkanik, pasi synon të garantojë respektimin e ligjit, të promovojë dialogun dhe të mbrojë parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut.

Ndërsa shumë nga vendet e Ballkanit po afrohen gjithnjë e më shumë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian apo integriteteve euro-atlantike, (dhe këtu gjej rastin të ndaj me ju lajmin e mirë për çeljen e negociatave me Shqipërinë për grupkapitullin e parë) gjykatat kushtetuese kanë një rol kyç në garancinë që legjislacionet kombëtare të pasqyrojnë vlerat dhe parimet demokratike perëndimore.

Kjo Konferencë, por dhe çdo veprimtari e kësaj natyre, është jo vetëm një model dhe një praktikë e bashkëpunimit produktiv ndërmjet sistemeve dhe institucioneve, për të përballuar sfidat e përbashkëta politike, ligjore, ekonomike e kulturore, por, në thelb është përpjekje nëpërmjet nesh për vetë qytetarët e Ballkanit Perëndimor dyke synuar garantimin e barazisë dhe përafrimin drejt standardeve të njëjta.

Si Presidente e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, ju ftoj të vazhdojmë të punojmë në sinergji me njëri-tjetrin dhe me partnerët tanë euro-atlantikë, pasi vetëm së bashku mund të ndërtojmë sisteme më të forta dhe më të qëndrueshme të demokracisë dhe të qeverisjes që ka në bazë parimet dhe vlerat kushtetuese e garanton respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Të nderuar Kolegë,

Duke shfrytëzuar këtë rast të veçantë të mikëpritjes nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, dëshiroj të sjell në vëmendje, se aplikimi i saj për anëtarësim në Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Evropiane është aktualisht në proces dhe se ky forum shërben si një mundësi për të evidentuar përkushtimin e Kosovës ndaj demokracisë kushtetuese, respektimit të ligjit dhe të të drejtave të individit, çka janë në themel të vetë Konferencës dhe gjykatave anëtare të saj.

Siç kanë nënvizuar Etërit Themelues të Kushtetutës Amerikane, liria është gjithnjë e rrezikuar prej tiranisë dhe, si e tillë, është më vështirë të ruhet e garantohet, sesa të vendoset. Garante dhe mbrojtëse e lirisë është Kushtetuta dhe Gjykatat Kushtetuese janë rojtar të saj.

Zonja e zotërinj,

Konferenca e këtij viti me temë “Evolucionet në Drejtësinë Kushtetuese Bashkëkohore: Shembulli i Rajonit të Ballkanit”, është një mundësi e shkëlqyer për të reflektuar mbi zhvillimet e rëndësishme të kohës që jetojmë.

Distanca që na ndan nga pjesa tjetër e kontinentit, Bashkimit European, është politike, ekonomike, kulturore, por edhe ligjore. Në fakt janë vlerat kushtetuese dhe të drejtat e njeriut ato që i zvogëlojnë këto distanca dhe pse jo na përbashkojnë në të njëjtën pikë.

Do të doja të citoja këtu professor Kristaq Krajën i cili thotë “Drejtësia kushtetuese është një revolucion intelektual i qytetërimit”, derisa përcjell në praktikë barazinë përpara vlerave që qëndrojnë në themel të tij. Praktikisht kjo drejtësi ka si standard Kushtetutën por kjo e fundit nuk është një ligj i thjeshtë i vendosur nga pushteti. Ajo është një nocion gati i përafërt me të drejtën, pra me rregullat që janë rezultat i asaj marrëveshjeje themelore për të bashkëjetuar dhe në shërbim të të cilave dalin dhe duhet të dalin ligjet.

Drejtësia kushtetuese në vendet tona është në një fazë transformuese, duke u adaptuar ndaj ndryshimeve të thella shoqërore dhe standardeve ndërkombëtare.

Sa më shpejt, sa më eficient dhe sa më me standarde të jetë ky transformim, aq në shpejt dhe aq më shumë do të përparojnë shoqëritë tona drejt idealit të shoqërisë demokratike.

Sfidë të vazhdueshme mbeten për demokracitë tonë nevojat e qytetarëve për transparencë, përgjegjësi, llogaridhënie dhe mbrojtje të të drejtave të tyre, si pjesë integrale dhe një forcë drejtuese e këtij transformimi.

Ndërsa konstitucionalizmi është shprehje e shtetit të së drejtës dhe drejtësia kushtetuese mjeti realizues i tij, sfida thelbësore e gjykatave tona kushtetuese është që përmes drejtësisë kushtetuese të garantojmë drejtësi efektive për qytetarët tanë, në mënyrë që konstitucionalizmi të mos jetë dekorativ, çka do të ishte më e rrezikshme se sa vetë mungesa e një sistemi kushtetues. Ndaj ne duhet të jetësojmë Kushtetutën, ta bëjmë të prekshme dhe të luftojmë që rregullat supreme që ajo mbart të materializohen dhe të mos mbeten thjesht një fasadë.

Prandaj forume dhe veprimtari të tilla janë të rëndësishme dhe të dobishme sepse na lejojnë të punojmë së bashku dhe në mënyrë komplementare për të adresuar këto sfida të sotme dhe të nesërme.

Angazhimi dhe kontributi ynë në shpejtësinë, thellësinë dhe përmasat e ndryshimeve në drejtësinë kushtetuese në vendet tona pasqyrojnë

përkushtimin tonë të palëkundur ndaj ndërtimit të sistemit demokratik, pavarësisë së pushteteve dhe sundimit të ligjit.

Dëshiroj të përsëris mirënjohjen time të thellë ndaj Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për organizimin e jashtëzakonshëm të kësaj konference.

Planifikimi i kujdesshëm dhe përkushtimi për këtë aktivitet janë një pasqyrim i rëndësisë që Republika e re e Kosova i jep rolit të Gjykatës Kushtetuese në garantimin e drejtësisë dhe sistemit demokratik.

Në përfundim, më lejoni të rikonfirmoj përgjegjësinë e madhe që mbajmë si gjyqtarë kushtetues.

Jam e bindur se diskutimet që do të zhvillojmë këtu sot do të jenë të pasura, konstruktive dhe do të kontribuojnë në konsolidimin e drejtësisë kushtetuese në vendet tona, si një përgjigje ndaj kërkesave të vetë qytetarëve dhe aspiratave të popujve tanë.

Le të punojmë që të garantojmë drejtësinë kushtetuese për mbrojtjen efektive të të drejtave themelore, për një të ardhme ku të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, ku askush nuk është mbi ligjin, por edhe askush nuk është nën ligjin.

Kushtetuta është për shtetin, por në radhë të parë është për qytetarët. Është domethënëse që shumë kushtetuta, përfshirë tonat, fillojmë me fjalët “Ne, populli”, që do të thotë se Kushtetuta, ligjet dhe qeverisja që ndërtohet prej tyre burojnë nga qytetarët dhe janë në shërbim të tyre.

Kushtetuta është ajo marrëveshje e të gjithë ne, që jetojmë në një komunitet, për të ndarë ato vlera që i quajmë të denja për qenien njerëzore.

Ju faleminderit!